



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT

KORÇË
VENDIM

Nr // Datë 10.05.07

PËR

PËR MIRATIM FONDI PREJ 1.069.920 LEKE PËR PJESËMARRJEN E TRUPËS SË TEATRIT "A.Z.ÇAJUPI" NË FESTIVALIN "HAPËSIRA TEATRALE E BALLKANIT" NË SHËN PETËRBURG - RUSI

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sektori i Kulturës dhe Drejtoria e Financës për "PËR MIRATIM FONDI PREJ 1.069.920 LEKË PËR PJESËMARRJEN E TRUPËS SË TEATRIT "A.Z.ÇAJUPI" NË FESTIVALIN "HAPËSIRA TEATRALE E BALLKANIT" NË SHËN PETËRBURG", bazuar në ligjin nr. 8652 dt 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32, pika "dh", Udhëzimin nr 2 dt 17.01.2007 të M.F. "Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2007", Udhëzimin nr 353 dt.19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", V.K.M nr. 228 dt. 13.04.2001 "Për dietat e nënpunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre", V.K.M nr 66 dt. 07.02.2007 "Për disa ndryshime në Vendimin nr 146 dt. 26.02.1998 të Këshillit të Ministrave "Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve", të ndryshuar, si dhe V.K.B. nr 2 dt.02.02.2007 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007», mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë fondin prej 1.069.920 lekë për pjesëmarrjen e trupës së teatrit « A.Z.Cajupi » në festivalin « Hapësira teatrale e Ballkanit » në Shën Petërburg - Rusi.

2. Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të Bashkisë me këtë strukturë buxhetore :

Pakësohet 00 04980 05 Art 6091100 - 1.069.920 lekë

Shtohet 00 08250 05 Art 6020000 + 1.069.920 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Sektori i Kulturës në Bashki dhe Qendra Ekonomike e Kulturës.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Rajmonda NASE
Rajmonda NASE